LEGJISLACIONI
41%
33%
KËSHILLI BASHKIAK
56%
19%
TRANSPARENCA FINANCIARE
42%
33%
KONSULTIMI PUBLIK
54%
35%
12%
INFORMACIONE TË TJERA
38%
40%
NIVELI I TRANSPARENCËS
50%
38%

KAMËZ

#12


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
65%
54%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
55%
30%
LEGJISLACIONI
32%
38%
KËSHILLI BASHKIAK
50%
40%
TRANSPARENCA FINANCIARE
36%
22%
KONSULTIMI PUBLIK
32%
41%
INFORMACIONE TË TJERA
61%
47%
11%
NIVELI I TRANSPARENCËS
50%
39%

LIBOHOVË

#13

2019		2017
63%	E DREJTA E INFORMIMIT	58%
46%	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	50%
50%	LEGJISLACIONI	50%
31%	KËSHILLI BASHKIAK	50%
44%	TRANSPARENCA FINANCIARE	50%
54%	KONSULTIMI PUBLIK	41%
51%	INFORMACIONE TË TJERA	65%
49%	NIVELI I TRANSPARENCËS	54%

5%

GRAMSH

#14


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
65%
100%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
50%
75%
LEGJISLACIONI
45%
33%
KËSHILLI BASHKIAK
59%
37%
TRANSPARENCA FINANCIARE
42%
33%
KONSULTIMI PUBLIK
7%
36%
INFORMACIONE TË TJERA
57%
47%
NIVELI I TRANSPARENCËS
7%
48%
55%

PATOS

#15


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
93%
81%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
50%
43%
LEGJISLACIONI
45%
31%
KËSHILLI BASHKIAK
39%
62%
TRANSPARENCA FINANCIARE
31%
35%
KONSULTIMI PUBLIK
43%
9%
INFORMACIONE TË TJERA
35%
31%
5%
NIVELI I TRANSPARENCËS
48%
43%

POGRADEC

#16


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
35%
56%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
51%
40%
LEGJISLACIONI
45%
29%
KËSHILLI BASHKIAK
47%
37%
TRANSPARENCA FINANCIARE
43%
45%
KONSULTIMI PUBLIK
46%
32%
INFORMACIONE TË TJERA
59%
63%
NIVELI I TRANSPARENCËS
48%
46%
2%

DROPULL

#17


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
65%
44%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
46%
50%
LEGJISLACIONI
50%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
41%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
44%
32%
KONSULTIMI PUBLIK
54%
27%
7%
INFORMACIONE TË TJERA
35%
32%
47%
NIVELI I TRANSPARENCËS
40%

KËLCYRË

#18


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
63%
44%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
50%
50%
LEGJISLACIONI
33%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
31%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
44%
26%
KONSULTIMI PUBLIK
40%
50%
INFORMACIONE TË TJERA
53%
74%
NIVELI I TRANSPARENCËS
47%
51%
4%

TROPOJË

#19


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
56%
36%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
38%
38%
LEGJISLACIONI
45%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
78%
85%
TRANSPARENCA FINANCIARE
31%
12%
KONSULTIMI PUBLIK
46%
45%
INFORMACIONE TË TJERA
41%
46%
NIVELI I TRANSPARENCËS
47%
42%
5%

PËRMET

#20


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
58%
70%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
40%
50%
LEGJISLACIONI
33%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
33%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
39%
50%
KONSULTIMI PUBLIK
54%
50%
INFORMACIONE TË TJERA
60%
74%
NIVELI I TRANSPARENCËS
13%
46%
59%


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
44%
67%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
48%
40%
LEGJISLACIONI
45%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
50%
85%
TRANSPARENCA FINANCIARE
50%
35%
KONSULTIMI PUBLIK
43%
68%
INFORMACIONE TË TJERA
44%
58%
NIVELI I TRANSPARENCËS
46%
56%
10%

BELSH

#22


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
67%
60%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
56%
47%
LEGJISLACIONI
50%
31%
KËSHILLI BASHKIAK
41%
44%
TRANSPARENCA FINANCIARE
33%
44%
KONSULTIMI PUBLIK
7%
9%
INFORMACIONE TË TJERA
54%
41%
NIVELI I TRANSPARENCËS
46%
42%
4%

TEPELENË

#23

2019		2017
46%	E DREJTA E INFORMIMIT	67%
40%	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	50%
33%	LEGJISLACIONI	50%
33%	KËSHILLI BASHKIAK	50%
34%	TRANSPARENCA FINANCIARE	34%
54%	KONSULTIMI PUBLIK	41%
68%	INFORMACIONE TË TJERA	66%
46%	NIVELI I TRANSPARENCËS	53%

7%

ELBASAN

#24


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
63%
56%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
29%
33%
LEGJISLACIONI
45%
33%
KËSHILLI BASHKIAK
27%
28%
TRANSPARENCA FINANCIARE
44%
41%
KONSULTIMI PUBLIK
57%
59%
INFORMACIONE TË TJERA
53%
64%
2%
NIVELI I TRANSPARENCËS
45%
47%


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
54%
81%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
44%
50%
LEGJISLACIONI
45%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
34%
54%
TRANSPARENCA FINANCIARE
44%
50%
KONSULTIMI PUBLIK
35%
45%
INFORMACIONE TË TJERA
50%
69%
15%
44%
NIVELI I TRANSPARENCËS
59%

HIMARË

#26


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
56%
52%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
38%
29%
LEGJISLACIONI
30%
4%
KËSHILLI BASHKIAK
33%
49%
TRANSPARENCA FINANCIARE
44%
12%
KONSULTIMI PUBLIK
43%
36%
INFORMACIONE TË TJERA
56%
37%
11%
NIVELI I TRANSPARENCËS
44%
33%

GJIROKASTËR

#27

2019		2017
44%	E DREJTA E INFORMIMIT	69%
39%	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	50%
30%	LEGJISLACIONI	50%
69%	KËSHILLI BASHKIAK	50%
44%	TRANSPARENCA FINANCIARE	35%
43%	KONSULTIMI PUBLIK	100%
39%	INFORMACIONE TË TJERA	82%
44%	NIVELI I TRANSPARENCËS	63%

19%

KURBIN

#28


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
58%
58%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
50%
50%
LEGJISLACIONI
32%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
50%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
50%
32%
KONSULTIMI PUBLIK
32%
36%
INFORMACIONE TË TJERA
24%
50%
4%
NIVELI I TRANSPARENCËS
43%
47%

DEVOLL

#29

2019		2017
47%	E DREJTA E INFORMIMIT	60%
50%	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	47%
36%	LEGJISLACIONI	38%
16%	KËSHILLI BASHKIAK	54%
50%	TRANSPARENCA FINANCIARE	50%
39%	KONSULTIMI PUBLIK	50%
46%	INFORMACIONE TË TJERA	43%
42%	NIVELI I TRANSPARENCËS	49%

7%

MIRDITË

#30


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
58%
31%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
50%
50%
LEGJISLACIONI
45%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
44%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
22%
24%
KONSULTIMI PUBLIK
32%
55%
INFORMACIONE TË TJERA
39%
58%
3%
42%
NIVELI I TRANSPARENCËS
45%

KORÇË

#31


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
37%
59%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
36%
57%
LEGJISLACIONI
30%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
27%
58%
TRANSPARENCA FINANCIARE
28%
44%
KONSULTIMI PUBLIK
54%
32%
INFORMACIONE TË TJERA
63%
70%
NIVELI I TRANSPARENCËS
14%
41%
55%

LEZHË

#32


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
44%
64%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
42%
57%
LEGJISLACIONI
32%
52%
KËSHILLI BASHKIAK
50%
49%
TRANSPARENCA FINANCIARE
31%
41%
KONSULTIMI PUBLIK
32%
65%
INFORMACIONE TË TJERA
45%
37%
NIVELI I TRANSPARENCËS
40%
51%
11%

DELVINË

#33


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
50%
67%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
40%
50%
LEGJISLACIONI
42%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
22%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
19%
50%
KONSULTIMI PUBLIK
50%
82%
INFORMACIONE TË TJERA
54%
66%
NIVELI I TRANSPARENCËS
19%
40%
59%

MALIQ

#34


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
62%
72%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
44%
45%
LEGJISLACIONI
45%
31%
KËSHILLI BASHKIAK
35%
42%
TRANSPARENCA FINANCIARE
44%
44%
KONSULTIMI PUBLIK
46%
41%
INFORMACIONE TË TJERA
15%
74%
NIVELI I TRANSPARENCËS
14%
40%
54%

	2019	2017
E DREJTA E INFORMIMIT	51%	47%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM	30%	26%
LEGJISLACIONI	30%	33%
KËSHILLI BASHKIAK	25%	59%
TRANSPARENCA FINANCIARE	33%	33%
KONSULTIMI PUBLIK	29%	33%
INFORMACIONE TË TJERA	64%	55%
NIVELI I TRANSPARENCËS	39%	42%

3%


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
63%
36%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
52%
50%
LEGJISLACIONI
36%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
47%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
36%
26%
KONSULTIMI PUBLIK
0%
9%
INFORMACIONE TË TJERA
26%
44%
NIVELI I TRANSPARENCËS
0%
38%
38%


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
28%
54%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
50%
48%
LEGJISLACIONI
41%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
47%
42%
TRANSPARENCA FINANCIARE
36%
38%
KONSULTIMI PUBLIK
0%
9%
INFORMACIONE TË TJERA
50%
35%
NIVELI I TRANSPARENCËS
2%
38%
40%

VLORË

#38


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
62%
56%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
40%
22%
LEGJISLACIONI
30%
8%
KËSHILLI BASHKIAK
36%
40%
TRANSPARENCA FINANCIARE
31%
0%
KONSULTIMI PUBLIK
43%
33%
INFORMACIONE TË TJERA
23%
45%
NIVELI I TRANSPARENCËS
38%
31%
7%

KUÇOVË

#39


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
56%
54%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
27%
24%
LEGJISLACIONI
45%
48%
KËSHILLI BASHKIAK
23%
45%
TRANSPARENCA FINANCIARE
25%
21%
KONSULTIMI PUBLIK
45%
64%
INFORMACIONE TË TJERA
44%
40%
NIVELI I TRANSPARENCËS
3%
37%
40%

LIBRAZHD

#40


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
48%
67%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
50%
50%
LEGJISLACIONI
27%
31%
KËSHILLI BASHKIAK
41%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
25%
50%
KONSULTIMI PUBLIK
11%
9%
INFORMACIONE TË TJERA
42%
38%
NIVELI I TRANSPARENCËS
8%
37%
45%

KAVAJË

#41

2019		2017
52%	E DREJTA E INFORMIMIT	51%
32%	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	17%
21%	LEGJISLACIONI	8%
33%	KËSHILLI BASHKIAK	21%
44%	TRANSPARENCA FINANCIARE	10%
25%	KONSULTIMI PUBLIK	0%
42%	INFORMACIONE TË TJERA	19%
37%	NIVELI I TRANSPARENCËS	20%

17%


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
50%
67%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
41%
45%
LEGJISLACIONI
23%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
44%
42%
TRANSPARENCA FINANCIARE
33%
44%
KONSULTIMI PUBLIK
21%
50%
INFORMACIONE TË TJERA
32%
46%
NIVELI I TRANSPARENCËS
13%
36%
49%

DIVJAKË

#43


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
44%
59%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
32%
37%
LEGJISLACIONI
42%
27%
KËSHILLI BASHKIAK
42%
46%
TRANSPARENCA FINANCIARE
20%
38%
KONSULTIMI PUBLIK
32%
36%
INFORMACIONE TË TJERA
41%
30%
NIVELI I TRANSPARENCËS
36%
4%
40%

SELENICË

#44


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
56%
0%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
43%
17%
LEGJISLACIONI
36%
0%
KËSHILLI BASHKIAK
32%
32%
TRANSPARENCA FINANCIARE
31%
0%
KONSULTIMI PUBLIK
7%
0%
INFORMACIONE TË TJERA
37%
29%
NIVELI I TRANSPARENCËS
23%
36%
13%

URA VAJGURORE

#45



KOLONJË

#46


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
33%
43%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
43%
45%
LEGJISLACIONI
32%
44%
KËSHILLI BASHKIAK
33%
50%
TRANSPARENCA FINANCIARE
35%
50%
KONSULTIMI PUBLIK
11%
41%
INFORMACIONE TË TJERA
34%
39%
NIVELI I TRANSPARENCËS
11%
33%
44%

MALLAKASTËR

#47




2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
19%
6%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
30%
50%
LEGJISLACIONI
14%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
50%
42%
TRANSPARENCA FINANCIARE
44%
41%
KONSULTIMI PUBLIK
11%
50%
INFORMACIONE TË TJERA
41%
49%
NIVELI I TRANSPARENCËS
9%
32%
41%


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
57%
59%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
27%
31%
LEGJISLACIONI
35%
31%
KËSHILLI BASHKIAK
33%
27%
TRANSPARENCA FINANCIARE
0%
42%
KONSULTIMI PUBLIK
48%
50%
INFORMACIONE TË TJERA
28%
30%
NIVELI I TRANSPARENCËS
7%
31%
38%

SHIJAK

#50


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
43%
32%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
29%
33%
LEGJISLACIONI
35%
33%
KËSHILLI BASHKIAK
21%
74%
TRANSPARENCA FINANCIARE
28%
25%
KONSULTIMI PUBLIK
29%
26%
INFORMACIONE TË TJERA
34%
64%
NIVELI I TRANSPARENCËS
11%
31%
42%

FIER

#51

2019		2017
56%	E DREJTA E INFORMIMIT	69%
53%	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	36%
0%	LEGJISLACIONI	27%
0%	KËSHILLI BASHKIAK	33%
26%	TRANSPARENCA FINANCIARE	19%
14%	KONSULTIMI PUBLIK	44%
37%	INFORMACIONE TË TJERA	53%
11%	NIVELI I TRANSPARENCËS	42%
31%		

DIBËR

#52


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
57%
44%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
29%
55%
LEGJISLACIONI
36%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
27%
58%
TRANSPARENCA FINANCIARE
6%
50%
KONSULTIMI PUBLIK
7%
41%
INFORMACIONE TË TJERA
39%
52%
NIVELI I TRANSPARENCËS
20%
30%
50%

MAT

#53


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
41%
37%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
33%
27%
LEGJISLACIONI
6%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
19%
38%
TRANSPARENCA FINANCIARE
25%
41%
KONSULTIMI PUBLIK
29%
36%
INFORMACIONE TË TJERA
41%
39%
NIVELI I TRANSPARENCËS
30%
37%
7%

BERAT

#54

2019		2017
31%	E DREJTA E INFORMIMIT	50%
28%	ORGANIZIMI I BRENDSHËM	23%
15%	LEGJISLACIONI	31%
40%	KËSHILLI BASHKIAK	15%
15%	TRANSPARENCA FINANCIARE	32%
29%	KONSULTIMI PUBLIK	50%
36%	INFORMACIONE TË TJERA	38%
29%	NIVELI I TRANSPARENCËS	34%

5%

FINIQ

#55


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
37%
51%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
50%
51%
LEGJISLACIONI
30%
31%
KËSHILLI BASHKIAK
25%
42%
TRANSPARENCA FINANCIARE
17%
50%
KONSULTIMI PUBLIK
30%
50%
INFORMACIONE TË TJERA
10%
43%
NIVELI I TRANSPARENCËS
19%
28%
47%

SARANDË

#56


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
44%
61%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
36%
52%
LEGJISLACIONI
36%
13%
KËSHILLI BASHKIAK
19%
83%
TRANSPARENCA FINANCIARE
31%
38%
KONSULTIMI PUBLIK
0%
56%
INFORMACIONE TË TJERA
23%
42%
22%
28%
NIVELI I TRANSPARENCËS
50%

KUKËS

#57

	2019	2017
E DREJTA E INFORMIMIT	34%	56%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM	24%	27%
LEGJISLACIONI	30%	44%
KËSHILLI BASHKIAK	27%	74%
TRANSPARENCA FINANCIARE	11%	35%
KONSULTIMI PUBLIK	37%	30%
INFORMACIONE TË TJERA	32%	41%
NIVELI I TRANSPARENCËS	28%	43%

15%

HAS

#58


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
31%
36%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
30%
43%
LEGJISLACIONI
45%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
34%
27%
TRANSPARENCA FINANCIARE
22%
35%
KONSULTIMI PUBLIK
7%
36%
INFORMACIONE TË TJERA
24%
10%
NIVELI I TRANSPARENCËS
4%
27%
31%


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
34%
67%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
21%
44%
LEGJISLACIONI
9%
31%
KËSHILLI BASHKIAK
25%
42%
TRANSPARENCA FINANCIARE
17%
62%
KONSULTIMI PUBLIK
24%
58%
INFORMACIONE TË TJERA
34%
36%
NIVELI I TRANSPARENCËS
25%
25%
49%

FUSHË-ARRËZ

#60



BULQIZË

#61


2019
2017
E DREJTA E INFORMIMIT
35%
61%
ORGANIZIMI I BRENDSHËM
24%
20%
LEGJISLACIONI
15%
50%
KËSHILLI BASHKIAK
17%
21%
TRANSPARENCA FINANCIARE
11%
26%
KONSULTIMI PUBLIK
0%
39%
INFORMACIONE TË TJERA
9%
30%
NIVELI I TRANSPARENCËS
17%
17%
34%

5. Konkluzione dhe Rekomandime

Katër vjet pas zbatimit në praktikë të ndarjes së re territoriale të vendit dhe detyrimit të njësive të reja të pushtetit vendor për zbatimin e kuadrit rregullator lidhur me të drejtën e informimit dhe konsultimin publik, shumica e bashkive nuk marrin dot një notë kaluese në këtë drejtim. Gjetjet e monitorimit të nivelit të transparencës së 61 bashkive të vendit gjatë vitit 2019 tregojnë një situatë lehtësisht të përkeqësuar të transparencës proaktive në faqet e internetit dhe në ambientet fizike të njësive të pushtetit vendor të krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të kryer në vitin 2017. Si rrjedhojë, shumica e rekomandimeve të mëparshme me synim përmirësimin e nivelit të transparencës dhe nxitjen e konsultimit publik në nivel vendor mbeten të pa realizuara.

- Pavarësisht pajisjes së të gjitha bashkive të vendit me një faqe aktive interneti, si dhe miratimit të një Programi Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, niveli mesatar i transparencës online në vitin 2019 përllogaritet në vetëm 31%. Pavarësisht situatës së përkeqësuar, një pjesë e pikëve të mbledhura nga bashkitë gjatë monitorimit të tyre online lidhet me ndihmën që japin në drejtim të transparencës një sërë organizatash jo-fitimprurëse, duke vënë në dyshim qendrueshmërinë e rezultateve në kohë.
- Hartimi i programit të ri të transparencës nga të gjitha bashkitë do të bënte të mundur lehtësimin e publikimit të dokumentacioneve që sipas ligjit duhet të bëhen publike pa kërkese. Bashkitë të cilët nuk e kanë hartuar ende një program të tillë, mund t'i referohen modelit që gjendet në adresën http://www.idp.al/programi-model-i-transparences-per-njesite-e-vete-qeverisjes-vendore/. Po kështu, formate të gatshme të kërkesës dhe ankesës mbi të drejtën e informimit gjenden në faqen www.idp.al ose në portalin www.pyetshtetin.al, të cilat mund të përdoren si të tilla në versionin elektronik/online ose mund të përshtaten në një format hardcopy.
- Përzgjedhja e duhur e stafit për pozicionin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Këto pozicione nuk janë detyrimisht pozicione të reja ose shtesë në organikën ekzistuese, por në shumicën e institucioneve publike janë pozicione ekzistuese që ngarkohen dhe me këto përgjegjësi shtesë. Përzgjedhja e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik ndër pjesëtarët e stafit që kanë statusin e nënpunësit civil, pra të mos jetë post politik. Kjo përzgjedhje do të kufizonte nga njëra anë vendimmarrjen politike lidhur me publikimin ose jo të dokumentacionit, si dhe do të mundësonte nga ana tjetër qendrueshmërinë e individëve të emëruar dhe eksperiencës së përfituar.
- Njohja e koordinatorëve me detyrat përkatëse, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i punës së tyre, ashtu si përcaktohet në tre ligjet kryesore që garantojnë transparencën e pushtetit vendor: Ligji nr. 139/2015 'Për Vetëqeverisjen Vendore'; Ligji nr.119/2014 'Për të Drejtën e Informimit' dhe

Ligji nr.146/2014 'Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik'. Gjithashtu, është e rëndësishme që koordinatorët të kenë akses të drejtpërdrejtë në faqet e internetit, si dhe këto të fundit të administrohen nga vetë stafi i bashkisë, në mënyrë që të sigurohet përditësimi sa më i shpeshtë i informacionit të publikuar.

- Lidhur me njoftimin dhe konsultimin publik, njësitë e pushtetit vendor duhet të fillojnë sa më parë përpjekjet për të publikuar njoftimet e tyre jo vetëm në faqet e tyre elektronike ose ambientet përkatëse, por dhe në portalin http://www.konsultimipublik.gov.al/, sipas kërkesave të VKM Nr. 828, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike". Gjithashtu, koordinatorët duhen të informohen dhe të publikojnë në faqet e internetit të bashkive procedurat e nevojshme për kryerjen e ankesës pranë zyrës së Komisionerit.
- Koordinatorët e secilës bashki duhet të konsultojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin www.pyetshtetin.al dhe të kërkojnë përditësimin e informacionit të publikuar në të lidhur me secilën bashki në rastet e emërimit ose ndryshimit të koordinatorit ose kontakteve të tij, hartimit të programit të transparencës, si dhe hartimit të regjistrit të kërkesave për të drejtë informimi dhe përgjigjeve.
- Institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe proaktive përmbushjen e detyrimeve për transparencë nga ana e njësive të pushtetit vendor, duke përdorur të gjitha mjetet dhe sanksionet e parashikuar në kuadrin rregullator në fuqi.

ANEKSI I

Metodologjia e detajuar

Ky monitorim ka për qëllim vlerësimin e transparencës së bashkive lidhur me kategoritë e informacionit që njësitë e pushtetit vendor bëjnë publike pranë ambienteve të tyre dhe në faqet e internetit pa kërkesë. Për këtë arsye, të 61 bashkitë e vendit janë monitoruar lidhur me publikimin e 55 indikatorëve që rrjedhin nga Ligji për të Drejtën e Informimit dhe Ligji mbi Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Monitorimi në terren u realizua nga 13 gazetarë lokalë të trajnuar dhe u zhvillua gjatë periudhës kohore Shkurt - Mars, 2019. Monitorimi i transparencës në faqet e internetit u realizua nga stafi i BIRN Albania gjatë të njëjtës periudhë kohore.

Gjatë kësaj faze të monitorimit, hapat e ndjekur për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave janë të ngjashme me ato të përdorur gjatë monitorimeve të mëparshme, në mënyrë që të mundësonin krahasimin e gjetjeve mes dy periudhave të ndryshme kohore.

Hapat e ndjekur për hartimin e metodologjisë së këtij monitorimi janë:

Identifikimi i Indikatorëve: Gjatë fazës së parë të këtij monitorimi, ekipit të ekspertëve të përfshirë në këtë vlerësim i lindi detyra që të detajonin dhe përshtatnin detyrimet që rrjedhin për publikim informacioni pa kërkesë nga Ligji për të Drejtën e Informimit dhe Ligji mbi Njoftimin dhe Konsultimin Publik për njësitë e qeverisjes lokale, duke qenë se dy ligjet e lartpërmendur i referohen detyrimeve të të gjithë autoriteteve publike. Në mënyrë më të detajuar, 45 indikatorë u identifikuan duke u analizuar neni 7 i Ligjit 119/2014 'Për të Drejtën e Informimit' mbi kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, ndërsa 5 indikatorë i referohen detyrimeve që rrjedhin nga Ligji 146/2014 'Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik'. Indikatorët e identifikuar u konsultuan me një grup më të gjerë ekspertësh dhe përfaqësuesish të institucioneve të përfshira në monitorim. Gjatë monitorimit të kryer gjatë vitit 2019, grupi i ekspertëve zgjeroi listën e indikatorëve dhe me 5 treguesë të tjerë me qëllim përshtatjen e monitorimit me formatin e ri të programit të transparencës së miratuar për njësitë e pushtetit vendor gjatë vitit 2018. Pavarësisht shtimit të 5 indikatorëve, hapat e tjerë të metodologjisë bëjnë të mundur krahasimin e nivelit të transparencës me vitet e mëparshme.

Kategorizimi i Indikatorëve: Në mënyrë që informacioni dhe rezultatet e këtij monitorimi të jenë sa më lehtë të kuptueshme dhe të krahasueshme mes bashkive, të 55 indikatorët e identifikuar të nivelit të transparencës u ndanë në shtatë kategori kryesore: E drejta e informimit; Organizimi i brendshëm; Legjislacioni; Këshilli Bashkiak; Transparenca Financiare; Konsultimi Publik dhe Informacione të

tjera. Listën e plotë të indikatorëve dhe ndarjen përkatëse në secilën kategori e gjeni në Tabelën 6.

Vlerësimi i Indikatorëve online: Vlerësimi i indikatorëve të transparencës në faqet e internetit të 61 bashkive u realizua online nga stafi i BIRN Albania i përfshirë në projekt. Procedura e vlerësimit dhe pikëzimit të indikatorëve online përmban disa hapa:

1. Përmes vëzhgimit dhe kërkimit të detajuar në internet, monitoruesit identifikuan të gjitha faqet ekzistuese të bashkive të vendit. Pas identifikimit të të gjithë faqeve zyrtare (përjashtuar faqet në rrjetet sociale), u vlerësua niveli i përditësimit të informacionit brenda tyre, duke përjashtuar nga analiza faqet e dyzuara elektronike që nuk kishin pasur asnjë përditësim vitin e fundit.
2. Faqet aktive të bashkive iu nënshtruan një vlerësimi të detajuar lidhur me publikimin e 55 indikatorëve të identifikuar të transparencës proaktive. Në rast se informacioni ose dokumenti i indikatorit është publikuar në faqen e internetit dhe mund të aksesohet i plotë përmes programit të transparencës së hartuar nga bashkia, atëherë transparenca e këtij indikatori vlerësohet me 6 pikë. Nëse informacioni ose dokumenti i indikatorit është publikuar në faqen e internetit por nuk mund të aksesohet përmes programit të transparencës sipas kërkesave ligjore (nuk është linkuar brenda fushave përkatëse), transparenca e indikatorit vlerësohet me 4 pikë. Në rastet kur informacioni ose dokumenti i indikatorit është publikuar në mënyrë të pjesshme në faqen e internetit, transparenca e indikatorit vlerësohet me 2 pikë (shiko Tabelën 4).
3. Në rastet kur informacioni ose dokumenti i indikatorit nuk është publikuar në faqe, transparenca e indikatorit vlerësohet me 0 pikë (shiko Tabelën 4). Për një numër shumë të vogël indikatorësh, të cilët i referohen dokumenteve jo-ekzistuese për disa nga bashkitë, atëherë këta indikatorë u përjashtuan nga përllogaritja e pikëzimit të nivelit të transparencës së bashkisë përkatëse (shiko indikatorët me '**' në Tabelën 6).

Tabela 4: Vlerësimi i indikatorëve në faqet e internetit.

Niveli i aksesit në dokumentacion/informacion	Pikët
Të publikuara në mënyrë të plotë dhe të aksesueshme (të linkuara) përmes programit të transparencës	**6**
Të publikuara në mënyrë të plotë në faqe por të pa-aksesueshme (të pa-linkuara) përmes programit të transparencës	**4**
Të publikuara në mënyrë të pjesshme në faqe	**2**
Dokumentacioni nuk është publikuar / nuk ekziston	**0**

Vlerësimi i Indikatorëve në terren: Vlerësimi i indikatorëve u realizua në terren pranë secilës nga 61 bashkitë e vendit nga 13 gazetarë të trajnuar për qëllimet e këtij monitorimi. Procedura e vlerësimit dhe pikëzimit në terren përmban disa hapa:

1. Përmes vëzhgimit, monitoruesit vlerësuan secilin nga indikatorët e bërë publik (afishuar ose shumëfishuar) nga vetë institucioni, pranë stendave të posaçme për informimin publik ose pranë zyrës së informimit publik / One Stop Shop. Në rast se informacioni ose dokumenti i indikatorit mund të aksesohet i plotë pranë ambienteve të bashkisë, atëherë transparenca e këtij indikatori vlerësohet me 6 pikë. Nëse informacioni ose dokumenti i indikatorit mund të aksesohet në mënyrë të pjesshme (p.sh. është publikuar emri i koordinatorit, por jo kontaktet e tij/saj), transparenca e indikatorit vlerësohet me 5 pikë (shiko Tabelën 5).
2. Pas vëzhgimit të mësipërm, informacioni ose dokumenti i indikatorëve që nuk mund të aksesoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë u kërkua nga ana e monitoruesve që të vihej në dispozicion. Kërkesa u krye gojarisht pranë ambienteve të bashkisë ndaj koordinatorit për të drejtën e informimit ose personelit të bashkisë pranë zyrës së informacionit / pritjes së publikut. Nëse informacioni ose dokumenti i indikatorit vihet në dispozicion të kërkuesit në format hardcopy gjatë vizitës së tij, transparenca e këtij indikatori vlerësohet me 3 pikë. Nëse informacioni ose dokumenti i indikatorit vihet në dispozicion të kërkuesit vetëm duke i referuar adresën elektronike të faqes që përmban informacionin (p.sh. disa nga bashkitë i referohen përmbushjes së publikimit të listës së anëtarëve të Këshillit Bashkiak përmes shpalljes së tyre në faqen elektronike të KQZ), transparenca e indikatorit vlerësohet me 2 pikë (shiko Tabelën 5).
3. Në rastet kur informacioni ose dokumenti i indikatorit nuk është përmbushur (p.sh. mund të mos jetë zgjedhur ende koordinatori i të drejtës së informimit) ose në rastet kur informacioni ose dokumenti ekziston po refuzohet të bëhet publik, transparenca e indikatorit vlerësohet me 0 pikë (shiko Tabelën 5).

Tabela 5: Vlerësimi i indikatorëve në terren.

Niveli i aksesit në dokumentacion/informacion	Pikët
Të afishuara në stendë në mënyrë të plotë	6
Të afishuara në stendë në mënyrë të pjesshme	5
Të vëna në dispozicion pas kërkesës në terren në format hardcopy	3
Dokumentacioni vihet në dispozicion vetëm përmes referimit në një faqe elketronike.	2
Dokumentacioni ekziston por refuzohet të vihet në dispozicion	0
Dokumentacioni nuk ekziston / nuk është hartuar	0

Për një numër shumë të vogël indikatorësh, të cilët i referohen dokumenteve jo-ekzistuese për disa nga bashkitë, atëherë këta indikatorë u përjashtuan nga përllogaritja e pikëzimit të nivelit të transparencës së bashkisë përkatëse si në monitorimin online, ashtu dhe në monitorimin në terren (shiko indikatorët me '**' në Tabelën 6).

Ponderimi i Indikatorëve: Secili nga indikatorët e përzgjedhur për monitorim u penderuan në bazë të peshës së tyre specifike nga 1 deri në 3 bazuar në rëndësinë e tyre në kuadër të vlerësimit të transparencës. Për shembull, publikimi i formatit të kërkesës për informim është ponderuar me 1, duke qenë se kuadri rregullator shprehet qartësisht se pavarësisht udhëzimeve të mundshme, institucionet duhet të trajtojnë çdo kërkesë për informacion pavarësisht formatit të përdorur nga i interesuari. Nga ana tjetër, publikimi i formatit të ankesës është ponderuar me 2, duke qenë se ajo duhet të jetë e plotë sipas të gjitha parashikimeve ligjore, ndërsa të pasurit të një koordinatori për të drejtën e informimit është ponderuar me 3. Njësitë e ponderimit (peshës specifike) për secilin indikator gjenden në Tabelën 6.

Analizimi i të dhënave: Pikët e vlerësimit të secilit indikator u ponderuan në bazë të rëndësisë së tij. Pikët maksimale të ponderuara të indikatorëve të secilës kategori formësojnë nivelin 100% të transparencës për kategorinë përkatëse, ndërsa pikët maksimale të ponderuara të të gjithë indikatorëve sëbashku përbëjnë nivelin maksimal të transparencës (100%) për secilën bashki. Për shembull, niveli i transparencës së kategorisë "E Drejta e Informimit" të një bashkie përllogaritet duke përpjesëtuar pikët e ponderuara të të tetë indikatorëve përbërës me numrin maksimal të pikëve të mundshme të transparencës për atë kategori. Në të njëjtën mënyrë, për të vlerësuar nivelin e përgjithshëm të transparencës, pikët e ponderuara të të 55 indikatorëve përpjesëtohen me pikët maksimale të mundshme. Kjo mënyrë analizimi dhe paraqitjeje e gjetjeve të këtij monitorimi mundëson vlerësimin e nivelit të përgjithshëm të transparencës, por dhe kategorive specifike të indikatorëve në përqindje.

Tabela 6: Indikatorët përbërës së secilës kategori dhe pesha specifike e secilit indikator.

Kategoria dhe Indikatorët përkatës	Pesha
E drejta e informimit	
A ka institucioni një koordinator të të drejtës së informimit?*	**3**
A ka miratuar institucioni një program të ri transparence?*	**3**
Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"	**2**
Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit (Emri, mbiemri, adresa e emailit, numër kontakti, orari i punës)	**3**

Adresa postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim	2
Formati i kërkesës për informim	1
Formati i ankimit të vendimit përkatës për informacionin e kërkuar	2
Regjistri i kërkesave për të drejtën e informimit dhe përgjigjeve ndaj tyre	2
Organizimi i brendshëm	
Struktura organizative/ organograma e bashkisë	3
Funksionet dhe detyrat e bashkisë	3
Shërbimet që ofron bashkia për qytetarët dhe bizneset	3
Strukturat e pagave për nëpunësit e Bashkisë	1
Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë	1
Kompetencat dhe detyrat e nënkryetarëve të bashkisë	1
Kompetencat dhe detyrat e administratorëve lokalë**	2
Kompetencat dhe detyrat e funksionarëve të lartë të Bashkisë	2
CV/ Biografitë e funksionarëve të lartë (Kryetarit, nënkryetarëve, administratorëve, drejtorëve të drejtorive)	3
Rregullorja e administratës së bashkisë	2
Lista e njësive administrative dhe nëndarjet e tyre**	3
Orari i pritjes së qytetarëve nga Kryetari i Bashkisë	1
Legjislacioni	
Ligji nr. 115/2014 'Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë'	3
Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020	2
Ligji nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore'	2
Ligj Nr. 68/2017 "Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore"	3
Ligje të tjera	1
Këshilli Bashkiak	
Lista e anëtarëve të Këshillit Bashkiak	3
Njoftimi për mbledhjen e ardhshme ose më të fundit të Këshillit Bashkiak dhe rendi i ditës	3
Vendimi i fundit i Këshillit Bashkiak	3

Rregullorja/Funksionet e Këshillit Bashkiak	2
Komisionet e Këshillit Bashkiak	2
Transparenca Financiare	
Buxheti i vitit aktual	3
Plani i shpenzimeve për vitin financiar aktual	3
Raporti vjetor për zbatimin e buxhetit të vitit të kaluar	3
Raporti i fundit i auditimit të brendshëm	2
Raporti i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (nëse ka)**	1
Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procesit të auditimit të brendshem ose të jashtëm	2
Lista e kontratave të prokurimeve publike të lidhura momentalisht (nëse ka)**	2
Informacione mbi shumën e kontraktuar, palët kontraktuese, përshkrimi i mallrave ose shërbimeve të kontraktuara, plan zbatimi (afate kohore) dhe monitorimi të tyre**	3
Konsultimi Publik	
A ka institucioni një koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik?*	3
Ligji nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"	2
Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik (Emri, mbiemri, adresa e emailit, numër kontakti, orari i punës)	1
Planin vjetor për vitin aktual në lidhje me konsultimin publik në procesin e vendimmarrjes	2
Procesverbali i të paktën një konsultimi publik të kryer gjatë vitit të fundit	3
Raport vjetor i transparencës në procesin e vendimmarrjes për vitin e kaluar (vetëm në monitorimin online)	2
Kopje e përmbledhjeve të hartuara për çdo akt që i është nënshtruar procedurës së njoftimit dhe konsultimit publik (vetëm në monitorimin online)	3
Procedura që duhet ndjekur për të bërë ankesë te Komisioneri	3
Informacione të tjera	
A është publikuar orari i punës së bashkisë?*	1
A ka një stendë/vend të posaçëm për afishimin e njoftimeve /dokumenteve /vendimeve?* (vetëm në monitorimin në terren)	3
A është vendosur stenda e njoftimit në një vend që mund të aksesohet edhe jashtë orarit të punës?* (vetëm në monitorimin në terren)	2

Numër telefoni në dispozicion të ankesave nga ana e qytetarit	**3**
Plani strategjik / zhvillimor i bashkisë	**3**
Marrëveshje ose projekte të përbashkëta me organizata, donatorë ose intitucione të tjera publike (nëse ka)**	**2**
Njoftime për vende të lira pune	**1**
Paketa fiskale e vitit aktual (taksat dhe tarifat për bizneset)	**3**
Informacion mbi lejet dhe licencat që jepen nga institucioni	**2**
Lista e institucioneve në varësi (si p.sh. Ndërmarrja e shërbimeve publike/ Policia Bashkiake/ Çerdhet/ etj.)	**3**
Të dhëna për vendndodhjen dhe kontaktet e institucioneve të varësisë	**2**

*Këta indikatorë janë vlerësuar vetëm me 'Po – 6 pikë' ose 'Jo – 0 pikë'
**Këta indikatorë u përjashtuan nga pikëzimi final në rastet kur nuk ekzistonin. Shembull: nëse një bashki nuk ka qenë asnjëherë subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ky indikator nuk u përfshi në përllogaritjen e nivelit të transparencës së përgjithshme ose kategorisë përkatëse.

Kufizime të metodologjisë: Metodologjia e përzgjedhur përmban disa kufizime. E para: monitoruesit e angazhuar në këtë vlerësim në terren janë gazetarë, çka mund të ndikojë në gatishmërinë e institucioneve për të ofruar informacionin ose dokumentin e kërkuar në hapin e dytë të mbledhjes së të dhënave. Një faktor tjetër që duhet të merret parasysh në gjetjet e këtij monitorimi është që gjatë hapit të dytë të vlerësimit në terren, punonjësit e bashkisë viheshin në dijeni të monitorimit. Kjo nënkupton që aksesi i anëtarëve të komunitetit në informacionin ose dokumentacionin e kërkuar mund të jetë dhe më i cunguar ose i vështirë sesa ai i vlerësuar në këtë raport. E dyta: gjetjet e monitorimit në terren dhe online i referohen vetëm periudhës specifike të realizimit të tij.

‘PUSHTETI VENDOR NËN LENTEN E TË DREJTËS PËR INFORMIM’

Një vlerësim krahasues i treguesve të transparencës në terren dhe online për 61 bashkitë e vendit

2017 - 2019

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri

Tiranë, 2019